

VENDIM
Nr.838, datë 6.12.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR
RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 4 BASHKI DHE 10
KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 4 (katër) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Fondi në vlerën 34 052 300 lekë (tridhjetë e katër milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind lekë), të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha